



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 12 qershor 2025, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Mbretëria e Belgjikës nënshkruan zyrtarisht Marrëveshjen mbi Zbatimin e Dënimeve.

Marrëveshjen e nënshkruan Administratorja e DHSK-së, Dr. Fidelma Donlon, dhe z. Zherar Div (Gérard Dive), shef i Autoritetit Qendror për Bashkëpunim me Gjykatat Penale Ndërkombëtare, në Ministrinë e Drejtësisë së Belgjikës në Bruksel. Sipas kësaj marrëveshjeje, personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara mund ta kryejnë dënimin me burgim në Belgjikë, në varësi të kushteve që cakton Kryetarja e Dhomave të Specializuara dhe miratimit të Belgjikës.

Marrëveshjen me Mbretërinë e Belgjikës mund ta gjeni në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Seanca e ardhshme e planifikuar në gjykatë është shqiptimi i Aktgjykimit të Apelit në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, më 15 korrik, në orën 10:00 paradite. Në korrik 2024, z. Shala u shpall fajtor për krimet e luftës së ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe u dënua me 18 vjet burgim. Krahës kësaj, në nëntor 2024, Trupi Gjykoës urdhëroi z. Shala të paguajë një shumë prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor. Z. Shala apeloj aktgjykimin si dhe urdhrin për zhdëmtim.

Në qoftë se dëshironi të ndiqni shqiptimin e Aktgjykimit të Apelit nga galeria për publikun në Dhomat e Specializuara në Hagë, jeni të lutur të regjistroheni në adresën PUBLIC@scp-ks.org. Seancën mund ta ndiqni edhe nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejt në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Në lajme të tjera, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara ishte në Kosovë këtë javë dhe u takua me shoqërinë civile, të rinjtë dhe studentët të drejtësisë në Mitrovicë dhe Prishtinë për të shpjeguar mandatin dhe proceset në gjykatë dhe për t'u dhënë pjesëmarrësve mundësinë të bëjnë pyetje. Ekipi u takua edhe me gazetarë në Prishtinë.

Në sajë të kontributit bujar të qeverisë zvicerane, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara udhëton në Kosovë pothuajse çdo muaj për të informuar njerëzit në Kosovë për mandatin dhe gjykimet e veta dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të tyre. Deri më sot, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim ka mbajtur 192 takime të tilla me mbi 4000 pjesëmarrës nga mbarë Kosova.

